



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:202298
Datë: 10.08.2022
Numri i dokumentit: 03315764

C.nr.1449/2019

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtarin Baki Shigjeqi, në çështjen juridiko - kontestimore të paditëses A.B., me numër personal, me vendbanim në rrugën “.....”, nr..... në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson av. A.Sh., nga Prizreni, kundër të paditurit J.P., me numër personal, me vendbanim në rrugën “.....”, nr..... në Prizren, të cilin me autorizim e përfaqëson B.P., nga Prizreni, për shkake të vërtetimit të së drejtës së pronësisë, vlera e kontestit 5,000.00 euro, pas mbajte se shqyrtimi kryesore publik me datë 10.08.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M
NË BAZË TË POHIMIT

- I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses A.B., nga Prizreni.
- II. VËRTETOHET** se e njëjta në bazë të parashkrimit fitues është pronare e ½ në ngastrën kadastrale nr. P-.....në sipërfaqe e përgjithshme prej 2901 m², në masat dhe dimensionet nga ana veri-perëndimore me gjatësi L=23.33m+24.59m, nga ana verilindore me gjatësi L=16.78m +15.22 m, nga ana jug-lindore me gjatësi L=26.86m+14.78m+5.47m, nga ana jug-perëndimore me gjatësi L=14.16m, me një thyerje 1.53m dhe nga ana veri-perëndimore me gjatësi L=3.3m+14.52m+3.8m, ne sipërfaqe prej 1604 m², në vendin e quajtur “Tusus”, me kulturë tokë bujqësore – vreshtat, e klasës së 3-të, ZK Prizren, dhe **detyrohet** i padituri J.P., nga Prizreni, që ta pranojë këtë fakt dhe të lejojë regjistrimin në librat kadastral, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.
- III. Secila palë** i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja A.P., nga Prizreni, përmes të autorizuarit të saj av. A.Sh., nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë kundër të paditurit J.P., nga Prizreni, për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë. E njëjta në padi kishte theksuar se këtë pjesë të paluajtshmërisë e kishte blerë në vitin 1972 nga i padituri, ku edhe ka ndërtuar shtëpitë e banimit, gjykatës i ka propozuar që ta aprovojë kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar.

I padituri, në përgjigje në padi nuk e kanë kontestuar faktin se paditëses ia ka shitur pjesë e tije të paluajtshmërisë në vitin 1972 dhe se paditësja në tërësi e ka përmbushur pagesën dhe se nuk ka asnjë obligim financiar ndaj tij.

Edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor i autorizuari i paditëses ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë, ku gjykatës i propozoi që të aprovojë kërkesëpadia e paditës dhe të vërtetohet që e njëjta është pronare e pjesës së ngastrës kadastrale P-....., në bazë të parashkrimit fitues, të cilën parcelë e ka në posedim që nga vitin 1972, mbështetur në ekspertizën e gjeodezisë ku në mënyrë detale është bërë përshkrimi i gjendjes faktike në terren. I njëjti theksoi se meqenëse i padituri

nuk e ka kundërshtuar kërkesëpadinë, gjykatës i propozoj që të merr aktgjykimin në bazë të pohimit. Shpenzimet procedurale nuk i ka kërkuar.

Po ashtu, edhe i autorizuari i të paditurit B.P., gjatë shqyrtimeve gjyqësore theksoi se qëndron në tersi pranë përgjigjes në padi, duke e pohuar kërkesëpadinë e paditëses padi re njëjta është vërtetuar në bazë të provave të administruara, dhe kërkoj nga gjykata që të njëjtën pa aprovoj.

Gjykata, për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike, ka dalë në vend për të bërë identifikimin e paluajtshmërisë kontestuese së bashku me ekspertin e gjeodezisë .S., dhe ka konstatuar se pjesa veri-lindore e ngastrës shfrytëzohet nga paditësja, në të cilën pjesë paditësja ka ndërtuar 4 objekte banimi me etazhitete të ndryshme, ndërsa pjesa jug-perendimore shfrytëzohet nga pronarët e tjerë. Pra, duke i marr parasysh të gjitha këto të lartcekura, gjykata ka vërtetuar se pjesa e ngastrës kadastrale me nr. P-....., në sipërfaqe e përgjithshme prej 2901 m², në masat dhe dimensionet nga ana veri-perëndimore me gjatësi L=23.33m+24.59m, nga ana veri-lindore me gjatësi L=16.78m +15.22 m, nga ana jug-lindore me gjatësi L=26.86m+14.78m+5.47m, nga ana jug-perëndimore me gjatësi L=14.16m, me një thyerje 1.53m dhe nga ana veri-perëndimore me gjatësi L=3.3m+14.52m+3.8m, në sipërfaqe prej 1604 m², në vendin e quajtur “Tusus”, me kulturë tokë bujqësore – vreshtat, e klasës së 3-të, ZK Prizren është pronë e paditësit A.B., gjë të cilën e kanë pohuar edhe i padituri. Andaj duke u bazuar në gjitha këto gjykata ka vendosur sikurse në dispozitivin I të këtij aktgjykimi.

Me nenin 148 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është paraparë se “*Në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata jep pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykim në bazë të pohimit)*”. Ndërsa në anën tjetër gjykata nuk gjeti ndonjë pengesë ligjore të paraparë me parag.2 të nenit të cekur më lartë, të cilat do të ndikonin në mos marrjen e këtij aktgjykimi. Në shkresat e lëndës gjendet prova të mjaftueshme të cilat e vërtetojnë bazën juridike të kërkesëpadiës, si dhe legjitimitetin aktiv dhe pasiv të palëve, përfshirë këtu edhe ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë Bajram Selmanaj të datës 20.06.2022 (e marr pas daljes së gjykatës në vend), në të cilën konstatohet gjendja faktike dhe juridike e ngastrës e cila është objekt shqyrtimi.

Në lidhje me vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata ka vendosur si në dispozitivin II të këtij aktgjykimi konform nenit 450 të LPK-së, meqenëse asnjëra palë nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 148 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2019:202298, 10.08.2022

G j y q t a r i

Baki Shigjeqi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në kuptim të nenit 181 paragrafi 1 dhe 2, në afat prej 15 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.